



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.141, datë 06.06.2022

PËR

**“ MIRATIMIN E PLANIFIKIMIT TREMUJOR TË VLERËSIMIT ETIK DHE
PROFESIONAL INDIVIDUAL TË PROKURORËVE, PËRGJATË VITIT 2022”**

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a” të Kushtetutës, në nenet 159, pika 2, germa “a” dhe “e”, 164, pika 8, 184, germa “dh”, 189, pika 1, germa “c”, të ligjit Nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenet 68, 84, 85 dhe 97, të ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në Rregulloren “Për Vlerësimin Etik dhe Profesional të Prokurorëve”, si dhe pasi u njoh me relacionin e propozuar nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë, planifikimin tremujor të vlerësimit etik dhe profesional individual të prokurorëve, përgjatë vitit 2022”, sipas aneksit Nr. 2 bashkëlidhur relacionit.
2. Ngarkohet Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Njësia e Mbështetjes së Komisioneve në Departamentin e Shërbimeve Ligjore dhe Prokurorët e komanduar pranë Këshillit pjesë e kësaj njësie për ndjekjen e këtij procesi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 06.06.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR

Alfred Balla

ZV/KRYETAR

Tartar Bazaj





ANËTAR

Sokol Stojani

ANËTAR

Bujar Sheshi

ANËTAR

Nurihan Setti

ANËTAR

Eloida Goxhi

ANËTAR

Esmeralda Keshi

ANËTAR

Ludovik Dodaj

ANËTAR

Zeqir Hoda

ANËTAR

Mirela Bogdani